



**Der  
Ehrentag**  
Für dich. Für uns. Für alle.



## Merrni pjesë në „Ehrentag“!

**Më 23 maj është Dita e Nderit.**

**Një ditë për ty, për ne dhe për të gjithë.**

Periodha e aktiviteteve  
16 deri më 31 maj 2026

“Dita e Nderit” është një ditë e re mbarëkombëtare e angazhimit qytetar, e vnedosur me rastin e ditëlindjes së Kushtetutës sonë me nismën e Kreut të Shtetit, Presidentit Federal Frank-Walter Steinmeier.

Fjala gjermane “Ehrentag” është një tjetër shprehje për ditëlindjen ose ditën e emrit të një personi. Në këtë rast i referohet Kushtetutës dhe njëkohësisht luan me kuptimin e fjalës “nder”: Është çështje nderi të angazhohesh për shoqërinë.

### Cila është ideja që e udhëheq Ditën e Nderit?

Demokracia jeton falë njerëzve pjesëmarrës. Prandaj ideja është: që në Ditën e Kushtetutës sonë, të gjithë njerëzit në Gjermani për disa orë të bëjnë së bashku diçka që e përmirëson sadopak vendin tonë. Me këtë rast, argëtimi dhe bashkësia duhet të jenë në qendër.

Kështu, Dita e Nderit i bashkon njerëzit – pavarësisht moshës, vendbanimit apo prejardhjes. Angazhimi për të mirën e përbashkët na forcon në ndjenjën se mund ta formësojmë botën tonë. Ai forcon besimin në shoqëri dhe mban gjallë demokracinë.

### Në këtë mënyrë mendo të marrin pjesë të gjithë

Merr pjesë edhe ti! Ka mënyra të ndryshme për t’u përfshirë:

Mund të bashkoheni në aktivitetet që organizohen pranë jush ose online. Shumicën e aktiviteteve i gjeni në [Engagement-Finder](#) në faqen [www.ehrentag.de](http://www.ehrentag.de). Numri i tyre shtohet çdo ditë.

Mund të organizoni edhe vetë një ngjarje dhe ta regjistroni në “Engagement-Finder”. Kjo mund të bëhet falas dhe në çdo kohë.

Bisedoni me njerëzit që i njihni – në punë, në shoqatë, në lagje. Çfarë keni dashur gjithmonë të përmirësoni? Të krijoni kontakte të reja? Të diskutoni në gjuhë të ndryshme, të shkëmbeni muzikë apo kulturë? Mund të organizoni një turne sportiv, një aksion pastrimi, një orë leximi, një festë në rrugë.



Ndoshta një ngajrje që e keni planifikuar tashmë, i përshtatet shumë mirë kësaj nisme?

Është e mirëpritur çdo nismë, sado e vogël, që forcon bashkëjetesën shoqërore.

Pastaj ftoni të tjerët t'ju bashkohen. Në [www.ehrentag.de](http://www.ehrentag.de) gjeni mjete të dobishme për planifikim dhe shumë shembuj të mirë – në gjermanisht dhe anglisht. Njoftimin tuaj mund ta publikoni edhe në disa gjuhë. Aktivitetet duhet të zhvillohen midis 16 dhe 31 majit 2026.



**Shumë e rëndësishme: Pjesëmarrja është vullnetare dhe duhet të sjellë kënaqësi!**



Der Bundespräsident



Deutsche Stiftung  
für Engagement  
und Ehrenamt

[www.ehrentag.de](http://www.ehrentag.de) – Dita e Nderit është një nismë e përbashkët e Presidentit Federal dhe Fondacionit Gjerman për Angazhim dhe Vullnetarizëm.